

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.07.2021*

**06.07.2021
Ora 11:11**

RENDI I DITËS

Projektvendim "Për pranimin për shqyrtim të Kërkesës Ankimore nr. 57, me objekt "Kundërshtimin e vendimit nr.420 të KSHZ, "Për shqyrtimin e denoncimit për shkelje të parashikuar në vendimin nr.9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në KOZ, ndaj "Albpetrol SH.A." me ankimues zotin Andi Derhemi".

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:**

Z. E. Lako: Atëherë çelim sot seancën e Komisionit të Ankimimeve dhe të Sanksioneve, për të verifikuar plotësimin e elementëve të formës dhe të përmbajtjes të ankimit nr. 57, të subjektit ankimues zotit Andi Derhemi, me objekt Kundërshtimin e vendimit nr.420, datë 29.06.2021 "Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuara në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator daj "Albpetrol" sh.a. Relator i kësaj seance jam zgjedhur une, Elvin Lako, sipas shortit të hedhur në datën 05.07.202, në mbështetje të nenit 129 të Kodit Zgjedhor. Të pranishëm në seancë janë anëtarët e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, administrata e KQZ-së e përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm, ndërsa subjekti ankues, megjithëse është njoftuar dhe ka dijeni për

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.07.2021**

mbledhjen e kësaj seance, nuk është i pranishëm. Shkurtimisht zoti Sekretar i Përgjithshëm dy fjalë në lidhje me përshkrimin e ngjarjes.

Z. Y. Merkaj: Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 420 datë 29.06.2021, ka shqyrtuar ankimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuara në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj “Albpetrol”, me ankimues zoti Andi Derhemi, i cili duke mos qenë dakord me këtë vendim të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, ka bërë ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve. Ankimi është dorëzuar në datën 05.07.2021 është brenda afatit dhe kërkesa ankimore mban numrin 57. Nga verifikimi paraprak i elementëve të formës dhe të përmbajtjes së kërkesës ankimore, konstatohet se është në përputhje me nenin 126 të Kodit Zgjedhor si dhe nenin 130 përfaqësuesi i KQZ-zë për shqyrtimin e ankimit është Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve. Legjitimi i ankuesit legjitimohet pasi janë prekur interesa të ligjshme të zotit Andi Derhemi. Gjithashtu është respektuar afati ligjor i ankimit, brenda afatit të parashikuar në ligj për të ankimuar vendimin nr. 420 datë 29.06.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Administrata propozon që të kalojë për shqyrtim.

Z. E. Lako: Faleminderit zoti Sekretar i Përgjithshëm, meqenëse nuk kemi përfaqësuesit, ankuesin apo ndonjë përfaqësues të tij... Nuk e di nga anëtarët e KAS-it ka ndonjë...në lidhje me plotësimin e elementëve, formës dhe të përmbajtjes. Po zoti Braho.

Z. L. Braho: Jam plotësisht dakord me relatimin që bëri përfaqësuesi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Legjitimitimin në bazë të nenit 124/1, pragrafi i dytë, e shoh

**Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI**



***Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.07.2021***

si element plotësor. Afati është ashtu siç u relatua, kështu që besoj se është për t'u kaluar për shqyrtim administrativ.

Z. E. Lako: Atëherë, kemi zoti Rusmali, zoti Çefa ndonjë koment tjetër? Atëherë tërhiqemi për të marrë vendimin.

Rifillon Mbledhja

Ora 11:57

Z. Elvin Lako: Atëherë, KAS vendosi që t'a kalojë këtë ankim për shqyrtim. Seanca e themelit do të zhvillohet nesër, në datën 07.07.2021 ora 09:00. Seancën e deklarojmë të mbyllur.

Vendimi nr.98

**Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.07.2021*

06.07.2021
Ora 12:04

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për pranimin për shqyrtim të Kërkesës Ankimore nr.58, me objekt “Kundërshtimi i vendimit nr.422, datë 02.07.2021 të KSHZ, “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të thelluar të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues, zotin Qerim Ismailaj, Kryetar i Bashkisë Mallakastës, Qarku Fier” me ankimues Partinë Demokratike të Shqipërisë”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:**

Z. K. Bele: Çelim seancën për shqyrtimin paraprak të Kërkesës Ankimore nr. 58, dt. 05.07.2021, me ankues Partia Demokratike e Shqipërisë. Objekt i ankimit, kundërshtimi i vendimit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhejve për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetdeklarues, zotin Qerim Ismailaj, Kryetari i Bashkisë Mallakastër, Qarku Fier. Verifikojmë prezencën. Prezent është administrata e KQZ-së e përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm. Relatoj që sipas shortit, relator jam zgjedhur unë, Koli Bele. Lidhur me njoftimin e ankuesit për këtë seancë? Po zoti Merkaj.

Z. Y. Merkaj: Është njoftuar ankuesi dhe është shprehur që të vazhdojmë në mungesë të tij.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.06.07.2021*

Z. K. Bele: Dakord atëherë, në këto kushte vazhdojmë shqyrtimin e ankimit. Relatojmë se në këtë fazë jemi vetëm në shqyrtimin e elementeve të formës, të ankimit. Paraprakisht pyesim administratën, zoti Sekretar?

Z. Y. Merkaj: Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është dorëzuar Kërkesa Ankimore nr. 58, paraqitur nga subjekti politik Partia Demokratike e Shqipërisë, e cila ankimon vendimin 422, dt. 02.07.2021 e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për shqyrtimin e rezultatit, të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme, për subjektin vetëdeklarues zotin Qerim Ismailaj, Kryetar i Bashkisë Mallakastër, Qarku Fier. Kundër këtij vendimi, brenda afatit ligjor, ka paraqitur ankim subjekti zgjedhor Partia Demokratike. Nga verifikimi paraprak i elementëve të formës dhe të përmbajtjes, administrata e KQZ-së përcakton se është në përputhje me nenet 126 dhe 130 të Kodit Zgjedhor dhe kërkesa duhet pranuar, faleminderit.

Z. K. Bele: Kemi ndonjë pyetje? Dakord, në këto kushte KAS i konsultuar në vend, vendosi me shumicë votash vendimin për seancë, për shqyrtimin administrativ, në datën 07.07.2021 ora 10:00.

Vendimi nr.99

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*

